



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2020

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

e.mail: _____

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 17.06.2020, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail dhe regjistruar me nr.8433 prot., datë 18.06.2020, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion për projektet social-ekonomike të ndërmarra pas Reformës Administrative Territoriale, ju bëjmë me dije se:

Në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër, mund të gjeni informacion të mjaftueshëm për studimin duke klikuar në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Buxheti_2020_1665_1.php

Tek Transparenca e Buxhetit në <https://buxheti.info/shkoder/>, tek zëri shpenzime, sipas programeve buxhetore do të gjeni informacion për periudhën 2016-2020.

Në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Buxheti_nder_Vite_1655_1.php, do të gjeni gjithashtu informacion të vlefshëm për studimin tuaj.

Planet strategjike të Bashkisë Shkodër, janë të publikuara në faqen e saj të internetit, në linkun http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Plani_i_pergjithshem_vendor_1420_1.php.

Në Bashkinë Shkodër kemi tregje publike dhe tregje private në të cilat tregtarët ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar. Sipas nevojës së analizuar në territor Bashkia Shkodër, ka bërë ndërhyrjet e saj me investime për përmirësimin e kushteve të këtyre tregjeve. Kështu është investuar në tregun e Rusit (treg ambulant për produktet bujqësore) gjithashtu është punuar për sa i përket tregjeve të lëvizshme në lagje të ndryshme të qytetit Shkodër. Gjithashtu është krijuar edhe tregu ambulant në Velipojë për sezonin veror. Siç do të vëreni edhe në Planin Strategjik, Bashkia Shkodër ka të parashikuar ndërtimin e tregut të peshkimit, tregut të produkteve Bio dhe zgjerimit të tregut rajonal ekzistues në Shkodër.

Bashkia Shkodër në kuadër të promovimit të bizneseve vendase dhe produktit lokal organizon panairë të përvitshme. Panairët organizohen në njësitë administrative Shkodër si

dhe në qytetin e Shkodërs për të promovuar dhe reklamuar produktet lokale. Çdo vit, organizohet dhe panairi i punës në bashkëpunim me bizneset, universitetin dhe zyrën e punës. http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Per_Biznesin_153_1.php

Hartimi i buxhetit, planeve strategjike dhe projekteve është bërë në bashkëpunim me grupet e interesit, bazuar dhe në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Të gjitha njoftimet, takimet dhe diskutimet mund ti gjeni duke klikuar në linkun http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Keshillim_me_Publikun_301_1.php

Funksionimi i Zyrave me Një Ndalesë, jo vetëm në qendër por dhe në njësitë administrative, ka rritur në maksimum efikasitetin e shërbimeve kundrejt qytetarë. Pavarësisht shërbimit që kërkohet, qytetari nuk e ka të nevojshme të paraqitet në bashkinë qendër, por mund ta bëjë kërkesën dhe në njësinë administrative ku ai banon

Duke ju uruar mbarëvajtje në studimin tuaj.

KRYETAR

Voltana Ademi